



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:187936

Datë: 22.02.2021

Numri i dokumentit: 01527332

PKR. nr. 01/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me Kryetarin e trupit gjykues Mustaf Tahiri dhe zyrtare ligjore Gentiana Hoxha, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.D., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/L.nr.200/20 të datës 12.01.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik me datë 12.02.2021, në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Rasim Maloku, të akuzuarit I.D., të njejtën ditë shpalli dhe publikisht komunikoi, ndërsa me datë 22.02.2021 përpiloi me shkrim, këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

I.D., i lindur me dt..... në Lipjan, nga i ati M. e ëma Gj.e vajzërisë S., me vendbanim në Lipjan-.....me adrese rruga, me numër personal, i martuar , prind i 5 femijeve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën ekonomike, i gjendjes së mesme financiare, me pune te përkohshme ne Gj. dhe A..

ËSHTË FAJTOR

Sepse, me datë 16 tetor 2020, rreth orës 14:00 në fshatin Davidovc – Shtime, ka mbajtur në posedim pa autorizim armët në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit mbi Armët 05/L-02, në atë mënyrë policia një pikë kontrolli ka ndaluar të pandehurin i cili ishte duke vozitur me veturë, gjatë kontrollit, në trupin e tij – jelekun që përdoret përdoret për gjuajtje me armë, në fatrollën

nën krahun e majtë është gjetur arma e zbrazët e llojit pistoletë, e markës Sarsilmaz B6, e kalibrit 9x19 mm, me numër serike prodhimit turk, ngjyrë e zezë, për të cilën posedonte lejen për armë shenjëtarie, me numër të cilës i kishte skaduar afati me datë 20.09.2020, kurse në brendësi të veturës është gjetur një karikator me 9 fishekë të kalibrit 9x19 mm, të cilat janë sekuestruar nga policia.

- me të cilën ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69,dhe 70 të KPRK-ës, si dhe nenit 365 të KPPK-ës, e

G J Y K O N

me DËNIM ME GJOBË në lartësi prej 300 € (treqind) euro, i cili dënim do të paguhet 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 43 par. 3 të KPRK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 (njëzet) Euro do të vuaj nga një ditë burgimi.

Konform nenit 366 par. 3 të KPRK-së, konfiskohen në mënyrë të përhershme armët dhe atë arma e llojit pistoletë, e markës Sarsilmaz B6, e kalibrit 9x19 mm, me numër serike prodhimit turk, ngjyrë e zezë si dhe një karikator me 9 fishekë të kalibrit 9x19mm.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30/tridhjetë/€, shumën prej 50/pesëdhjetë/€ për fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimin, të cilat obligohet që ti paguaj në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

1. Historiku procedural

Prokuroria e Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda me aktakuzën PP/I.nr.200/20, të datës 12.01.2021, ka akuzuar I.D. për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Kryetari i trupit gjykues duke vepruar sipas kësaj akuze ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 12.02.2021, në të cilën i pandehuri është deklaruar fajtor për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza duke shtuar se për këto armë ka poseduar leje mirëpo për të njëjtën nuk ka pasur dijeni se afati i lejes kishte skaduar këtë gjë e kishte kuptuar pas kontrollit nga policia e Kosovës, kërkon falje për veprimin e tij, do të ketë kujdes në të ardhmen lidhur me afatet e lejeve dhe premtion gjykatës se më nuk do të përsëris vepra të tilla apo të tjera penale.

Prokurori i shtetit lidhur me këtë ka deklaruar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit mbështet në provat dhe faktet e çështjes dhe përputhet në tërësi me përshkrimin faktik ashtu që janë plotësuar kriteret ligjore për pranimin e fajësisë të parapara në nenin 248 të KPP-së dhe nga kjo i propozon Gjykatës që të pranohet pranimin e fajësisë. Gjykatës i propozoj që pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Pasi i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar, Gjykata shqyrtoi me kujdes faktet e përcaktuara nga neni 248 par.1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi:

- I akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit
- Pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit
- Pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i shtetit përkatësisht: Raporti i oficerit i dt.16.10.2020, Vërtetim për sekuestrimin e sendeve e dt.16.10.2020, fotografi të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore.
- Si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, andaj gjyqtari konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

2. Vlerësimi i veprimeve të të akuzuarit

Kryetari i trupit gjykues vlerësoi se në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha tiparet subjektive dhe objektive të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, meqë të akuzuarit në ditën kritike gjatë kohës sa ishte duke vozitur me veturën e tij është ndalur në një pikë kontrolle nga policia e Kosovës ku gjatë kontrollit në trupin e tij është gjetur një jelek që përdoret për gjuajte me armë, një armë e zbrazët e llojit pistoletë, e markës Sarsilmaz B6, e kalibrit 9x19 mm, me numër serike prodhimit turk, ngjyrë e zezë, për të cilën posedonte lejen për armë shenjëtarie, me numër të cilës i kishte skaduar afati me datë 20.09.2020, kurse në brendësi të veturës është gjetur një karikator me 9 fishekë të kalibrit 9x19 mm, të cilat janë sekuestruar nga policia.

4. Vlerësimi i dënimit të shqiptuar

Gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 të KPK-së. Si rrethanë veçanërisht lehtësuese mori, pranimin e fajësisë që në seancën fillestare si dhe gjendjen ekonomike të tij, pendimin e thellë, premtimin se më nuk do të përsëris vepra të tilla apo të ngjashme, se është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, ndërsa nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me dënimin e shqiptuar është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPK-ës, se edhe me anë të këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës speciale dhe do të ndikoj në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale pra në kuptim të preventivës gjenerale.

3. Konfiskimi dhe shpenzimet procedurale

Konform nenit 366 par. 3 të KPRK-së, konfiskohen në mënyrë të përhershme armët dhe atë arma e llojit pistoletë, e markës Sarsilmaz B6, e kalibrit 9x19 mm, me numër serike prodhimit turk, ngjyrë e zezë si dhe një karikator me 9 fishekë të kalibrit 9x19mm.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në nenin 450 par. 2 pika 6 të KPPK-së, ndërkaq vendimi për pagesën në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit është i bazuar në nenin 39 par. 3 nën par. 3.2 të LKVK-së.

Nga arsyet e lartpërmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA

PKR. nr. 01/21, më 22 shkurt 2021.

**Zyrtare Ligjore,
Gentiana Hoxha**

**Kryetari i trupit gjykues,
Mustaf Tahiri**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 dite, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Numri i lëndës: 2020:187936
Datë: 22.02.2021
Numri i dokumentit: 01527332